

# AKT THEMELIMI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SABATEL" SH.P.K.

Sot me daten 1/08/2000, ndermejte paleve te meposhteme:

1. **Sali Saliu**, shtetas shqiptar, i biri i Beqos, lindur me 10/09/1951 ne Babice te madhe e banues ne Babice te Madhe, me Leter Njoftim EV Nr. 257842, me detyre Administrator i Shoqerise "SABATEL" SH.P.K.
2. **Izder Avdullai**, shtetas shqiptar, i biri i Salikos, lindur me 21/03/1957 ne Babice te madhe e banues ne Babice te Madhe, me Leter Njoftim 0018938 (Pasaporta)

Lidhet kjo kontrate me kushtet dhe marredheniet si me poshte:

### NENI 1

Personat fizike te siperpermendur , me vullnetin e tyre te lire dhe me pajtim me legjislacionin shqiptar , rane dakort qe te krijoje shoqerine e perbashket me pergjegjesi te kufizuar ( SH.P.K.) me emertim "SABATEL" SH.P.K.

Shoqeria do ta kete seline e saj ne : Babice te Madhe dhe do te njihet me emrin "SABATEL" SH.P.K.

Kapitali i saj eshte 100.000 leke

Ortaket e kesaj shoqerie dhe pronare te pasurise se saj jane:

**Sali Saliu**

**Izder Avdullai**

Shoqeria "SABATEL" SH.P.K. ka te drejte te krijoje filiale te saj brenda dhe jashte vendi , ne çdo kohe qe te çmohet e nevojeshme dhe e aresyeshme prej saj dhe me miratim te organeve kompetente.

### NENI 2

Shoqeria gezon statusin e personit Juridik.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit dhe legjislacionit ne fuqi. Statuti i Shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.



### **NENI 3**

Veprimatria e Shoqerise si person juridk fillon me aprovimin e krijimit te saj nga ana e organeve kompetente te shtetit dhe do te vazhdoje per nje periudhe kohe mbi 10 vjete.

Shoqeria e mbaron aktivitetin e saj me kalimin e afatit te parashikuar ne kete kontrate, nese ortaket , me vullnetin e tyre te lire nuk e zgjatin kete afat.

Shoqeria e mbyll veprimatrine e saj edhe para afatit te parashikuar ne paragrafin e pare te ketij neni, nese per kete marrin vendim unanim te gjithë ortaket qe bejne pjese ne kete shoqeri.

### **NENI 4**

Shoqeria "SABATEL" Sh.p.k. do te kete si objekt:

*"Operatore te telekomunikacioneve rurale dhe ofrus sherbimi ne telekomunicacion.Import Export i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, farmaceutike, mallra konsumi, paisje shtepiake, veshje te gateshme, metrazhe, artikuj plastike, materiale ndertimi, pajisje elektrike, mekanike, mjete transporti, makineri bujqesore, te pjeseve te nderimit te plehrave bujqesore, dhe farerave per bujqesine etj. me shumice dhe pakice, transportimi i tyre, hoteleri, bar restorante, servise automjetesh dhe makineri bujqesore, sherbime komunale, turizem, agjensi detare etj."*

### **NENI 5**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 lek.

Ne krijimin e ketij kapitali ortaket marrin pjese me keto kontribute:

Sali Saliu me 50%

Izder Avdullai me 50%


Kapitali i Shoqerise depozitohet ne llogarine e Shoqerise ne nje nga bankat e Shtetit shqiptar.

### **NENI 6**

Fitimi neto qe do te realizohet nga veprimatria e kesaj shoqerie do te ndahet midis ortakeve me proporcion me kapitalin e tyre ne kete shoqeri.

### **NENI 7**

Per detyrimet qe do te krijohen ndaj personave te trete gjate aktivitetit te kesaj shoqerie , kjo shoqeri pergjigjet vetem me kapitalin e saj. Ortaket nuk



mbajne pergjegjesi per detyrimet e shoqerise me pasurine e tyre qe nuk ben pjese ne kapitalin e kesaj shoqerie.

#### **NENI 8**

Nuk mund te pranohet ne kete shoqeri si ortak nje person tjeter , pa pelqimin unanim te ortakeve te tjere.

Nuk mund te hiqet dore nga kjo kontrate ne menyre te njeaneshme pa pelqimin e ortakeve te tjere.

Ortaku qe deshiron te shese pjesen e tij ne kete shoqeri eshte i detyruar qe oferten e tij per shitje tua beje ortakeve te tjere dhe nese keta te fundit nuk pranojne ta blejne ose nuk japin pergjigje brenda 30 diteve nga data e berjes se ofertes , vetem atehere ortakut eshte i lire te disponoje pjesen e tij.

#### **NENI 9**

Ortaket jane te detyruar ta ruajne karakterin konfidencial te aktivitetit te shoqerise.

Ortaku qe shkel detyrimin e mesiperme dhe nga kjo shkelje shoqerise i shkaktohet nje dem , eshte i detyruar te shperbleje demin.

#### **NENI 10**

Marredheniet e punes te shoqerise ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

#### **NENI 11**

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen midis tyre me mirekuptim. Ne qofte se ortakët nuk merren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim , kopetente per zgjidhjen e tyre eshte Gjykata e Rrethit.

#### **NENI 12**

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne Statutin e saj.

Ortakët pasi e lexojne me vemendje Kontraten e mesiperme dhe e gjejne ate konforme vullnetit te tyre , firmosin rregullisht.

### **O R T A K E T**

**SALI SALIU**  
*Sali Saliu*

**IZDER AVDULLAI**  
*Izder Avdulla*

# STATUTI

## I

### SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR "SABATEL" SH.P.K.



#### DISPOZITA TE PERGJITHESHME

##### NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "SABATEL" Sh.p.k. themelohet ne perputhje me Ligjin Nr. 7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare". Kjo shoqeri krijohet nga ortaket:

1. *Sali Saliu*, shtetas shqiptar, i biri i Beqos, lindur me 10/09/1951 ne Babice te madhe e banues ne Babice te Madhe, me Leter Njoftim EV Nr. 257842, me detyre Administrator i Shoqerise "SABATEL" SH.P.K.

2. *Izder Avdullai*, shtetas shqiptar, i biri i Salikos, lindur me 21/03/1957 ne Bbaice te madhe e banues ne Babice te Madhe, me Leter Njoftim

*0018938 (Pasaporte)*

Shoqeria ka seline e saj ne Babice te Madhe

Shoqeria ka te drejte te kete edhe filiale , dege e perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise dhe jashte saj; ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe ate te vendeve te tjera ku ato do te hapen.

##### NENI 2

Administrator i shoqerise "SABATEL" Sh.p.k. do te jene Sali Saliu

Administratori perfaqeson Shoqerine ne marredhenie me te tretet dhe ne Organet shteterore e gjyqesore. Ai mund te delegojne pjese te funksioneve te tij tek persona te tjere duke leshuar prokura.

Ai kane per detyre organizimin dhe drejtimin e Shoqerise ne pershtatje me Kontraten e Themelimit dhe Statutin e Shoqerise

##### NENI 3

Shoqeria "SABATEL" Sh.p.k. e zhvillon veprimatrine e saj ne perputhje ne legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (Kontrata dhe ketij Statuti)

Shoqeria eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Gjykate.

#### **NENI 4**

Shoqeria krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje mbi 10 vjet.

Shoqeria mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose mund te mbylle aktivitetin e saj para afatit e parashikua ne kete statut , sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 5**

Shoqeria "SABATEL" Sh.p.k. per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet, pergjigjet vetem me pasurite e saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e Shoqerise e pasurine e tyre qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Pjesmarrja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore, organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

#### **NENI 6**

Shoqeria "SABATEL" Sh.p.k. do te kete si objekt :

*"Operatore te telekomunikacioneve rurale dhe ofrus sherbimi ne telekomunicacion.Import Export i mallrave te ndryshme ushqimore, industriale, farmaceutike, mallra konsumi, paisje shtepiake, veshje te gateshme, metrazhe, artikuj plastike, materiale ndertimi, pajisje elektrike, mekanike, mjete transporti, makineri bujqesore, te pjeseve te nderimit te plehrave bujqesore, dhe farerave per bujqesine etj. me shumice dhe pakice, transportimi i tyre, hoteleri, bar restorante, servise automjetesh dhe makineri bujqesore, sherbime komunale, turizem, agjensi detare etj."*

Shoqeria eshte pronare , perdoruese dhe disponuese e pasurise te saj , ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se saj.


Shoqeria mund te bleje dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale , perfshire te drejten per te afruar pasurite e saj dhe per te marre kredi bankare.

## **K R E U II**

### **MARREDHENIET EKONOMIKO- FINANCIARE**

#### **NENI 7**

Kapitali themeltar i Shoqerise perbehet ne te holla ne nje ylere 100.000 leke



Ky kapital zoterohet nga Ortaket e kesaj Shoqerie ne kete menyre:

|                |     |
|----------------|-----|
| Sali Saliu     | 50% |
| Izder Avdullai | 50% |

Kapitali themeltar apo pjese te caktuara te tij jane te transferueshme si ndermjet ortakeve ashtu edhe perkundrejt personave te trete. Transferimi i kapitalit ose pjeseve te tij ndermjet ortakeve ose ne favor te nje personi te trete behet gjithmone me miratim unanim te te gjithë ortakeve dhe me akt noterial.

Ne qofte se njeri nga ortaket deshiron te shese pjesen e tij te kapitalit ne natyre , duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortaket e tjere.

Te gjithë veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e te gjithë ortakeve. Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga nje ekspert kompetent i caktuar nga ortaket.

#### **NENI 8**

Zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit themeltar ne teresi ose veçanti per nje ose disa ortake behet me vendim unanim te te gjithë ortakeve.

Kapitali themeltar dhe transferimet e tij regjistrohen ne nje regjister te veçante.

#### **NENI 9**



Fitimi neto i realizuar nga aktiviteti i Shoqerise te ndahet ndermjet ortakeve ne proporcion me pjeset e tyre takuese ne kapitalin themeltar.

#### **NENI 10**

Veprimtaria e Shoqerise realizohet ne baze te leverdive ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancin e saj. Bilanci i aktivitetit te Shoqerise duhet te perfundoje brenda muajt Mars te vitit pasardhes. Bilanci i aktivitetit te financuar mund te behet nga vete ortaket ose nga eksperte te caktuar prej tyre. Por ne te gjitha rastet rezultatet e bilancit financiar duhet te behen te njohura çdo ortaku dhe gjithmone rezultati perfundimtar duhet te merret ne shqyrtim nga asambleja e ortakeve, brenda gjashte muajsh nga dita e mbylljes se vitit financiar.

#### **NENI 11**

Shoqeria krijon fondet e saj per zhvillimin e zgjerimin e aktivitetit te saj , ne perputhje me rregullat ne fuqi.



Perberja e fondeve, burimet financiare te tyre, caktohen nga asambleja e ortakeve.

**NENI 12**

Shoqeria disponon plotesisht mjetet e saj financiare.

**K R E U III**

**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE**

**NENI 13**

Ortaket kane te drejta kryesore te cilat ushtrohen nepermjet vendimeve te marra nga Asambleja e ortakeve :

- Te marrin pjese ne administrimin e veprimatrise ekonomiko-tregetare te Shoqerise , ne perputhje me Kontraten dhe Statutin.
- Te kerkoje dhe tu jepen te dhena qe kane te bejne me gjendjen dhe veprimatrine e Shoqerise si dhe te gjitha dokumentat e perpunuara nga Shoqeria (Bilanci, libra llogarie).
- Te bejne propozime dhe ti paraqesin ato me shkrim para administratorit dhe Asamblese se Shoqerise.
- Te heqin dore nga Shoqeria ne kushtet qe percaktohen ne kontrate dhe ne kete statut.

**NENI 14**

*Ortaket kane keto detyra kryesore:*

- Te depozitojne kuoten e tyre ose kuoten suplementare ne perputhje me kontraten dhe me vendimet e Asamblese.
- Te marrin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- Te kryejne detyrat e ngarkuara nga Asambleja ose Administratori, per realizimin e detyrimeve te shoqerise.

**K R E U IV**

**ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIV I SHOQERISE**

**NENI 15**

Organi me i larte vendimor i Shoqerise eshte asambleja e ortakeve.



Ne Asamble marrin pjese te gjithe ortaket me te drejte vote sipas shumave te vena ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Asambleja e Ortakeve vendos per keto probleme:

- Miraton bilancin vjetor te Shoqerise
- Vendos per shtimin , pakesimin ose transferimin e kapitalit themeltar.
- Emeron dhe shkarkon Administratorin e Shoqerise.
- Ben modifikimin ne kontrate dhe statut sipas ecurive te shoqerise.
- Vendos per mbylljen e aktivitetit te Shoqerise ose shnderrimin e shoqerise.

Unanimiteti ne marrjen e vendimeve te Asamblese eshte i domosdoshem per keto çeshtje:

- Per modifikimin e kontrates dhe te statutit.
- Per rritjen , pakesimin ose transferimin e kapitalit themeltar per mbylljen e shoqerise.

Per çeshtje te tjera Asambleja vendos me shumice votash.

Asambleja e Ortakeve thirret jo me pak se nje here ne vit.

#### **NENI 16**

Administratori i Shoqerise emerohet dhe shkarkohet me miratimin e shumices se ortakeve qe kane mbi 1/2 e pjeseve te kapitalit themeltar.

Ai ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne emer dhe per llogari te shoqerise ne marredheniet me persona te trete.

Adnimistatoret nuk mund te kryejne detyrat qe i jane lene ne kompetence Asamblese se Ortakeve.

Shoqeria merr persiper te gjitha pasojat qe mund te vijne nga veprimet e administratorit sipas detyrave te tyre te caktuara ne Statut.

#### **NENI 17**

Administratoret jane pergjegjes individualisht ose solidarisht ndaj Shoqerise ose ndaj personave te trete, ku gjate veprimtarise se tyre shkelin ligjin, kontraten dhe statutin.

#### **NENI 18**

Marredheniet e punes me punetoret qe do te punesohen ne shoqeri , rregullohen me ane te kontrates individuale , qe lidhen me secilin prej tyre.





**K R E U V**  
**MBYLLJA E VEPRIMATRISE SE SHOQERISE**

**NENI 19**

Veprimtaria e Shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontrate , nese ortaket , me vullnetin e tyre te lire , nuk e zgjatin kete afat.

Ajo mund te pushoje veprimatrine e saj edhe para afatit te parashikuar ne kontrate kur per kete marrin vendim ortaket qe disponojne shumicen e kuotave te kapitalit themeltar.

Veprimtaria e shoqerise pushon edhe ne ato raste kur ortaket vendosin per shnderimin e shoqerise SH.P.K. ne shoqeri te nje lloji tjeter.

**NENI 20**

Kur Shoqeria likujdohet plotesisht , Asambleja e Ortakeve krijon Komisionin e Likujdimit , i cili paraqet bilancin e likujdimit.

Pasuria e Shoqerise , pasi shlyen detyrimet e Shoqerise , i ndahet ortakeve ne proporcion me kontributin e tyre ne kapitalin themeltar me vendim te ortakeve qe disponojne 3/4 e kuotave te kapitalit fillestar.


Pasuria qe eshte futur ne Shoqeri me te drejte shfrytezimi , i kthehet pronarit te saj.

**NENI 21**

Ky statuti u redulatua ne kater kopje dhe hyn ne fuqi ditën e nenshkrimit prej ortakeve te saj themelues.

**O R T A K E T**

Sali Saliu

*Sali Saliu*  


Izder Avdullai

*Izder Avdullai*  
